



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 231 Prot.

Tiranë, më 31.032015

VENDIM Nr. 26, datë 26.03.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 4, të datës 26.03.2015, pasi shqyrtoi "Relacionin mbi verifikimin në terren, për evidentimin e dy strukturave gjatë zbatimit të projektit "Rrjeti i ujësjellësit në qytetin e Lezhës dhe në Balldren"- Lezhë, paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik,

VENDOSI:

- I. Subjekti ndërtues "STRABAG AG", i cili po zbaton punimet për projektin "Rrjeti i ujësjellësit në qytetin e Lezhës dhe në Balldren"- Lezhë, të kontraktojë një subjekt të licensuar në fushën e arkeologjisë, i cili duhet të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve në zonën "A" dhe "B" të qytetit, duke lidhur kontratë tre palëshe më të dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.
- II. Subjekti i licensuar në fushën e arkeologjisë duhet të ndjekë një metodologji të përcaktuar për të gjithë zonën, nëpërmjet kryejës së sondazheve testues për segmente të caktuara të rrugëve, në të cilat kalon linja e ujësjellësit, për të përcaktuar mënyrën e gjurmimit për hapjen e kanaleve të ujësjellësit për to dhe, të depozitojë pranë DRKK Shkodër dhe ASHA, grafikun e punimeve për këto segmente. Në rast gjetjesh ai duhet të realizojë procesin e dokumentimit të tyre, dhe më tej të vijojë puna për zbatimin e projektit të ujësjellësit.
- III. DRKK Shkodër dhe ASHA të mbështetur nga subjekti ndërtues, do të dokumentojnë dy strukturat e gjetura gjatë zbatimit të projektit "Rrjeti i ujësjellësit në qytetin e Lezhës dhe në Balldren"-Lezhë, në pjesën e rrugës përballë godinës së Prefekturës Lezhë, në rrugën "Frang Bardhi". Për strukturën që përbëhet nga një bazament i poshtëm drejtkëndor sipër të cilit ngrihet një hark në formë qemeri, të shikohet mundësia e devijimit të linjës së ujësjellësit. Në pamundësi të tij, pas kryerjes së testeve të nevojshme, të vijojë zbatimi i projektit.



- IV. Gjatë zbatimit të punimeve të kryhet mbikqyrja arkeologjike nga DRKK Shkodër dhe Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO